



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.09/2017

Prishtinë, më 24 janar 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Miljana Nikoliq, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Lirije Kajtazi, Frashër Krasniqi, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Albulena Balaj- Halimaj dhe Mytahir Haskuka.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Teuta Prekazi-UN Human Rights, Gordana Subotiq- Melbourne University.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Mundësia e organizimit të konferencës rajonale mbi pozitën e femrës në shoqëri;
2. Të ndryshme.

1. Mundësia e organizimit të konferencës rajonale mbi pozitën e femrës në shoqëri

Kryetarja, tha se meqë nuk kemi prezent shumicën e anëtarëve të komisionit, në këtë mbledhje do të diskutojmë vetëm për pikat e rendit të ditës.

Teuta Haxhiu, tha se nëse e organizojmë këtë konferencë, propozoj që të jetë për rolin e gruas në shoqëri, në rajon. Ne ende nuk jemi të kënaqur me pozitën e gruas në vendimmarrje në

ekzekutiv, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror.

Për ta organizuar një konferencë rajonale, na duhet më shumë kohë.

Ajo theksoi se së pari duhet të dihen temat për të cilat do të diskutohet në konferencë dhe besoj se një ditë është e mjaftueshme dhe nuk duhet të ndalemi vetëm me këtë organizim.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se nëse dëshirojmë të arrijmë diçka në këtë drejtim, pra për organizimin e kësaj konference, duhet të angazhohemi dhe të kontribuojmë të gjithë.

Ajo propozoi që t'i adresohemi OSBE-së, me një kërkesë, ngase mendoj se janë të gatshëm për të bashkëpunuar në drejtimin e fuqizimit të rolit të femrës në shoqëri, por ndoshta do të japin kontributin e tyre edhe në aspektin e mbështetjes financiare, nëse ne shkojmë me projekt konkret. Ajo propozoi që konferenca të jetë dyditore.

Mexhide Mjaku-Topalli, nëse vendoset të jetë konferencë rajonale, duhet të definojmë sa ditë do të jetë, kush do ta udhëheqë, temat që do të trajtohen, të kihet parasysh gjithashtu rreth komisioneve homologe të shteteve që do të ftohen.

Kryetarja, tha se e rëndësishme është që po vendosim të kemi një konferencë rajonale dyditore, me temën: Pozita e gruas në shoqëri në vendet e rajonit, por kjo mos të jetë definitive. Ne prapë do të takohemi për detaje. Po ashtu, tha se në pjesën hyrëse do t'i kemi të ftuar edhe kryeministrin, kryetarin e Kuvendit etj.

Vendi i mbajtjes, fillimisht le të mbetet hotel "Sirius", dhe se prej kësaj konference do të dalim vetëm me konkluzione.

Saranda Bogujevci, tha se është mirë që të pyetën organizatat e ndryshme, si NDI apo KDI, për të parë mundësinë se a mund të na ndihmojnë diçka në aspektin financiar, sa i përket këtij organizimi.

Teuta Haxhiu, tha se të ftohen nga komisionet homologe, një nga Agjencia për Barazi Gjinore apo ministri, apo si ta kenë të rregulluar nëpër shtetet përkatëse dhe një nga shoqëria civile.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është mirë të ftojme anëtarët nga komisioni homolog, shoqëria civile të ftohet vetëm brenda Kosovës, por jo të shteteve të tjera.

Kryetarja, tha se tani po dakordohemi për disa pika, meqë nuk kemi anëtarë të mjaftueshëm për votim, por duhet të gjejmë momentin edhe për të vendosur në mbledhjen e radhës së komisionit.

Kryetarja, në fund konstatoi se të premtën, më dt.26 shkurt 2018, vendosim që si komision të shkojmë në drekë pune, ku i ftuar do të jetë edhe ambasadori i OSBE-së në Kosovë.

Gjithashtu, administrata e komisionit do të na përpilojë një draft- agjendë, lidhur me këtë konferencë rajonale.

2. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati deputetë të paraqitur për fjalë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

*E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje